

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 5, nenit 36 dhe nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.5/02 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.202/24), nenit 16 pika 5, nenit 23 dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Kërçovës (“Fletorja Zyrtare e Komunës së Kërçovës” nr.5/2013) dhe nenit 17 të Ligjit për monumentet memoriale dhe monumentet përkujtimore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.66/04, 89/08 dhe 152/15 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.103/21), si dhe në bazë të Ligjit për ndërtim (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 130/2009, 124/10, 18/11, 36/11, 49/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/15, 129/15, 217/15, 226/15, 30/16, 31/16, 39/16, 71/16, 103/16, 132/16, 35/18, 64/18 dhe 168/18 dhe “Gazeta zyrtare e RMV-së” nr. 244/19, 18/20, 279/20, 96/21, 227/22, 111/23, 115/23 dhe 224/2024) dhe neni 6 i Rregullores për formën dhe përmbajtjen e kërkesës, dokumentacionin e nevojshëm dhe ekzemplarin e aktvendimit për realizimin e ndërtimeve gjegjësisht vendosjen e pajisjes për të cilat nuk është e nevojshme leje për ndërtim (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 31/2011), Këshilli i Komunës së Kërçovës, në mbledhjen e 45-të të mbajtur më dt. \_\_.02.2025, miratoi:

## **P R O G R A M**

### **Për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personaliteteve të shquara me monumente përkujtimore në Komunën e Kërçovës për vitet 2025-2029**

#### **HYRJE**

Këshilli i Komunës së Kërçovës miraton këtë Program për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personaliteteve të shquara me monumente përkujtimore, me qëllim ruajtjen dhe kultivimin e historisë, si dhe vlerave historike dhe kulturore të qytetit.

Në territorin e Komunës së Kërçovës deri më tani janë ndërtuar një i konsiderueshëm i monumenteve, busta përkujtimore dhe pllaka përkujtimore. Pjesë e trashëgimisë së brezave të sotëm mbetet ruajtja e kujtimit për ngjarje të rëndësishme dhe personalitete të shquara nga historia dhe kultura e qytetarëve të komunës. Me vendosjen e monumenteve përkujtimore, do të shprehet respekti dhe kujdesi i qytetarëve të komunës ndaj ngjarjeve dhe personaliteteve të rëndësishme kulturore dhe historike, duke ruajtur kështu kujtimin për figurën dhe veprën e tyre. Përmes veprave artistike dhe arkitekturore të vendosura në hapësirat publike, do të shënohet një vlerësim i tillë dhe përkushtim.

Ky Program përcakton prioritetet që Komuna e Kërçovës do të përfshijë me shënimin e personaliteteve dhe veprave të figurave me rëndësi për historinë dhe kulturën, si dhe ngritjen e monumenteve përkujtimore në territorin e komunës.

Monumentet përkujtimore përfshijnë: busta, skulptura, pllaka, çezma, shatërvanë dhe vepra të tjera artistike e arkitekturore, të cilat, përmes përmbajtjes dhe shenjave të tyre, shënojnë ngjarje dhe personalitete nga historia dhe kultura e shtetit tonë, që janë të rëndësishme lokale.

Monumente përkujtimore mund të ngrëjë vetë komuna, në përputhje me Ligjin për monumentet memoriale dhe monumentet përkujtimore ("Gazeta zyrtare e RM" nr.66/04, 89/08 dhe 152/15) dhe ligje të tjerë përkatës.

Personat juridikë dhe fizikë mund të paraqesin nismë pranë Këshillit të komunës për ngritjen e monumentit përkujtimor, si dhe të investojnë fonde për ngritjen e tij.

### **QËLLIMET**

Qëllimet kryesore të këtij Programi janë:

- Sigurimi i një qëndrimi aktiv të Komunës së Kërçovës ndaj ngjarjeve dhe personaliteteve të rëndësishme.
- Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë materiale dhe shpirtërore, ngjarjeve historike dhe personaliteteve që kanë marrë pjesë në ato.
- Ruajtja dhe afirmimi i identitetit historik të Komunës së Kërçovës.

### **AKTIVITETET**

Aktivitetet e Komunës së Kërçovës në shënimin e ngjarjeve dhe personaliteteve të rëndësishme në komunë do të synojnë nxitjen, mbështetjen dhe ndihmën për realizimin e qëllimeve të këtij Programi, duke përfshirë:

- Ruajtjen e vazhdimësisë së shënimit të ngjarjeve dhe personaliteteve të rëndësishme;
- Shënimin me monumente përkujtimore të ngjarjeve dhe personaliteteve të shquara, të cilat i japin një vulë të veçantë Komunës së Kërçovës;
- Krijimin e një bashkëpunimi produktiv me shoqata, organizata dhe fonde, që realizojnë dhe mbështesin shënimin e këtyre datave dhe personaliteteve.

## NGRITJA, MBROJTJA DHE MIRËMBAJTJA E MONUMENTEVE PËRKUJTIMORE

Aktivitetet	Bartësit e aktivitetit	Mjetet
Mirëmbajtja e Qendrës përkujtimore “Nëna Shqiptare” në fsh. Zajaz	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	60.000 den.
Mirëmbajtja e monumentit përkujtimor të luftëtarëve të rënë në luftën nacional çlirimtare në Kalanë e Kërçovës	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	60.000 den.
Mirëmbajtja e bustit të Tane Caleski te stacioni i autobusave	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	15.000 den.
Mirëmbajtja e bustit të Mirko Mileski te shkolla e mesme	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	15.000 den.
Mirëmbajtja e bustit të Naim Frashërit te shkolla në fsh. Tuhin	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	15.000 den.
Mirëmbajtja e bustit të Gjergj Kastriot Skenderbeut te shkolla në fsh. Sërbicë	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	15.000 den.
Mirëmbajtja e bustit të D-r Vlladimir Polezhinoski te shkolla fillore në qytet me emrin e tij	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	15.000 den.
Mirëmbajtja e bustit të K. J. Pitu te shkolla fillore në qytet me emrin e tij	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	15.000 den.
Mirëmbajtja e bustit të Faik Konica te shkolla në fsh. Greshnicë	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	15.000 den.
Mirëmbajtja e bustit të Ollga Miceska te çerdhja e fëmijëve në qytet	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	15.000 den.

Mirëmbajtja e bustit të Hristo Uzunov te shkolla në fsh. Dërgovë	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	10.000 den.
Ngritja e bustit të Omer Kaleshit te Pallati i Kulturës	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	200.000 den.
Ngritja e bustit të Gjergj Kastriot Skenderbeut në Kalanë e Kërçovës	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	300.000 den.
Ngritja e bustit të Nënë Tereza në Kalanë e Kërçovës	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	250.000 den.
Ngritja e bustit të Mehmet Aqif Ersoj në Kalanë e Kërçovës	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	120.000 den.
Ngritja e bustit të Boris Trajkovski në Kalanë e Kërçovës	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	250.000 den.
Ngritja e bustit të Jusuf Albani në Kalanë e Kërçovës	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	150.000 den.
Ngritja e bustit të Sulejman Elezi në Kalanë e Kërçovës	Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me shoqata/institucione tjera	200.000 den.

Komuna e Kërçovës mund ta zgjerojë këtë Program edhe me monumente përkujtimore sipas nismave të personave juridikë dhe fizikë, në përputhje me Ligjin për monumentet memoriale dhe monumentet përkujtimore.

## **FINANCIMI DHE ZBATIMI I PROGRAMIT**

Financimi për ndërtimin e monumenteve përkujtimore, si dhe shpenzimet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tyre, do të kryhen nga mjetet e Buxhetit të Komunës së Kërçovës, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga donacionet dhe nga burime të tjera, në përputhje me ligjin.

Për disa aktivitete që nuk janë përfshirë në Program, por për të cilat Këshilli i Komunës së Kërçovës, me propozim të Kryetarit, do të vlerësojë se për nga aktualiteti dhe cilësia e tyre zgjojnë një interes të gjerë publik, do të parashikohen fonde shtesë nga Buxheti i Komunës së Kërçovës.

## **REALIZIMI**

Për ngritjen, ruajtjen, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe përdorimin e çdo monumenti përkujtimor të përfshirë në Program, Këshilli i Komunës do të miratojë një vendim të veçantë. Për çdo monument përkujtimor të përfshirë në Program, ose për realizimin e procedurës së ngritjes së tij, Këshilli i Komunës së Kërçovës do të emëroj një Këshill për ngritjen e monumentit përkujtimor. Përbërja dhe kompetencat e Këshillit përcaktohen në aktin për emërimin e tij. Nismën për plotësimin e këtij Programi për ngritjen e monumenteve përkujtimore, si dhe financimin e tyre, mund ta paraqesin personat juridikë dhe fizikë pranë Këshillit të Komunës së Kërçovës.

Ky Program hyn në fuqi me ditën e publikimit në “Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës.”

Nr. 08-\_\_\_\_ /\_  
\_\_\_\_.02.2025  
Kërçovë

**KËSHILLI I KOMUNËS SË KËRÇOVËS**  
Kryetar,  
Skender Xhabiri